

SHOQERIA _DURRES CONTAINER TERMINAL_ SH.A.

SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE TE MBYLLUR ME 31.12.2020

I . KUADRI KONTABEL I APLIKUAR

Ne pergatitjen dhe paraqitjen e ketyre pasqyrave financiare eshte aplikuar kuadri kontabel i parashikuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, te shpallura nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit.

Pershkrimi i politikave kryesore kontabel te perdorura

Aktivi, pasivi dhe pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve jane redaktuar ne baze te parimeve kontabile sic jane parimi i kujdesit, parimi i krahasueshmerise dhe parimi i kopetences.

Gjithashtu eshte zbatuar parimi i pergjitheshem i vijueshmerise ne aplikimin e kriterave te vleresimit dhe te paraqitjes se zerave te vecante te pasqyrave financiare. Ne bilancin prezent, jane paraqitur edhe shumate e zerave korespondues te vitit ushtrimor 2020 te klasifikuar sipas rregullave te parashikuara ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, me qellim qe ti bejme ato plotesisht te krahasueshem me ato te vitit ushtrimor 2019.

Me dt.03.02.2020, Shoqeria jone u ndodh perpara faktit te zbatimit te Urdherit te Ekzekutimit te Permbaruesit Gjygesor dhe Vendimi I Gjykates Administrative te Apelit dhe duke filluar nga ajo date Aktiviteti qe Durres Container Terminal ushtronte dhe te gjitha asetet e saj jane sekuestruar nga Zyra Permbarimore dhe u transferuan tek Autoriteti Portual Durres.

Aktualisht Durres-Container Terminal nuk ushtron aktivitetin ne terminalin e kontiniereve ne portin e Durresit, dhe eshte ne proces gjygesor me palet e tjera. Keto efekte jane pasqyruar dhe ne prognoze ne pasqyrat financiare te vitit 2020.

Aktivet afatgjata te patrupezuara

Aktivet afatgjata te patrupezuara jane paraqitur me koston e tyre historike te paksuar me amortizimin e akumuluar. Per amortizimin e tyre eshte perdorur metoda e amortizimit linear duke perdorur si baze te amortizimit vleren e tyre fillestare. Normat e amortizimit jane te njejta me ato te vitit te meparshem ushtrimor.

Aktivet afatgjata te trupezuara

Aktivet afatgjata te trupezuara jane paraqitur me koston e tyre historike te paksuar me amortizimin e akumuluar. Per amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale eshte perdorur metoda e amortizimit e vleres se mbetur duke perdorur si baze te amortizimit vleren e tyre te mbetur mbas zbritjes se amortizimit te akumuluar.

Keto aktive jane ekspozuar ne bilanc te klasifikuara sipas natyres se tyre ne kategori homogjene dhe ne mbeshtetje te parimit te materialitetit. Normat e amortizimit jane te njejta me ato te vitit te meparshem ushtrimor.

Normat kontabile te perdorura per aktivet afatgjata jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 5.

Per shkak te situates juridike dhe faktike te shoqerise, per asetet e e sekuestruara , eshte llogaritur zhvleresim dhe provigjon .

Inventari

Inventari eshte paraqitur me me vleren me te vogel ndermjet kostos se tyre te blerjes apo prodhimit te llogaritur sipas metodes FIFO, dhe vleres se mundesheme te realizimit te nxjerre nga cmimet e tregut.

Normat kontabile te perdorura per inventarin jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 4.

Kerkesat per arketim

Kerkesat per arketim jane paraqitur me koston e tyre te amortizuar, qe presupozon vleren fillestare te tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale te akumuluar si dhe minus zvogelimet nga renia ne vlere e mundesise per ti arketuar.

Normat kontabile te perdorura per inventarin jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 3.

Mjetet monetare

Mjetet monetare jane paraqitur me shumen e tyre efektive.

Shpenzimet e shtyra dhe te ardhura te shtyra

Shpenzimet e shtyra dhe te ardhura te shtyra jane vleresuar dhe paraqitur ne baze te parimit te kopetences apo te ndarjes se periudhave

Detyrimet

Detyrimet jane paraqitur me koston e tyre te amortizuar, qe presupozon vleren fillestare te tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale te akumuluar.

Kriteret e konvertimit te vlerave te shprehura ne valute te huaj.

Te drejtat, detyrimet si dhe gjendja e monedhes ne fund te vitit eshte vleresuar duke u konvertuar me kursin e kembimit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne fund te vitit.

Zerat e Pasqyres te te ardhurave dhe shpenzimeve

Postet e pasqyres te te ardhurave dhe shpenzimeve jane paraqitur dhe vleresuar ne perputhje me parimin e kujdesit dhe te kopetences te parashikuara keto ne SKK.

II. INFORMACIONE TE TJERA

Aktivt afatgjata te patrupezuara.

Shoqeria nuk ka aktive afatgjata te patrupezuara.

Aktive Financiare Afatgjata:

Huadhenie afatgjate mbi 1 vit : 139,291,219 Lek

Aktivitet afatgjate te trupezuara

Dinamika e aktiveve te qendrueshme te trupezuara paraqitet keshtu:

Shoqeria ka llogaritur amortizimin e ketyre aktiveve me keto norma, sipas vendimit te administrimit, duke zbatuar te njejtat norma ne % si ne vitet e meparshme ushtrimor.

Aktive Afatgjate materiale	Norma e amortizimit ne %	Metoda e llogaritjes
Vincat Portual levizes	5%	
Makineri e paisje	20%	
Mjete transporti	20%	
Mobilje dhe orendi etj	20%	Mbi vleren e mbetur
Pasisje informatike	25%	

Shpenzimet e amortizimit jane brenda normave fiskale dhe jane totalisht te njohura. Amortizimi i akumuluar dhe ai i vitit ushtrimor paraqitet ne pasqyren e meposhteme:

Amortizim vjetor i llogaritur eshte 7.929.757 lek
Gjendje ne vlere neto e AQT eshte 1.087.898 lek

Per vleren e mbetur te AQT te sekuestruar nga Pemrbarimi eshte llogaritur zhvleresim

Parapagime per Aktive afatgjate te porsitura: 86 590 000Lek

Inventari

Gjendjet e inventarit paraqitet ne kete tabele.

Inventari Fizike eshte zero

Informacione te tjera per inventarin:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Vlera e inventarit e njohur si shpenzim gjate periudhes | 14,135,068 leke |
| 2. Vlera e zhvleresuar e inventarit e sekuestruar | 91,024,846 leke |

Aktive te tjera financiare afatshkurta

Keto aktive perbehen nga zerat e meposhtem

1. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfytëzimit	20,694,473 lekë
2. Te drejta interes i arketueshem llogarite e grupit	6,071,463 leke
3. Te drejta te arketueshme te tjera:	22,527,337 leke
Nga keto :	
Tatim mbi fitimin i mbipaguar per vitin 2020	7,832,979 leke
TVSH e kreditueshme	13,661,969 leke
TVSH e mpipaguar ne dogane	14 284 leke
Te tjera te arketueshme	1,018,105 leke

Aktivitet monetare

Gjendja e aktiveve monetare sipas bilancit paraqitet:

1. Depozita ne banke	172,313 leke
2. Depozita ne arke	75,427 leke
Gjithesej	247,740 leke

Gjendja e llogarive bankare eshte e argumentuar me ekstaktet e leshuara nga bankat per daten 31.12.2019 ndersa gjendja e arkes eshte e barabarte me librin e arkes date 31.12.2019.

Banka	Monedha	Vlera	Vlera ne lek
Raiffeisen Bank	LEK		157,624
BKT lek	LEK		7,237
Raiffeisen USD	USD	10.09	-1,019
BKT USD	USD	33	3,375
Raiff.Bank ne Euro	EUR	22	2,726
BKT ne Euro	EUR	19	2,370
Totali			172,313

Pasivet afatshkurta

Shoqeria nuk ka kredi afatshkurta te marra.

Detyrimet afatshkurta paraqiten ne bilanc me shumen 42,703,540 leke.
Peshen me te madhe ne kete shume e mbajne detyrimet ndaj firmave si me poshte:

1. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit : **27,286,826 leke**
2. Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit **2,396,814 lek**

Detyrime te tjera perbehet si vijon:

Te pagueshme ndaj Punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore:

- | | |
|--|--------------|
| 1. Punonjesit paga per tu paguar +sig shoq | 476,664 leke |
| 2. Tatim page | 60,564 leke |
| 1. Tatimi ne burim | 3,600 leke |

Pasivet afatgjata

Ne pasivet afatgjata futen kredite e marre nga shoqeria. Shoqeria nuk ka kredi afatgjata.

Diferencat e konvertimit te monedhave ne valute te huaj

Veprimet me monedhe te huaj jane konvertuar me kursin e dates se kryerjes se transaksionit. Tepricat e zerave monetare ne bilanc jane konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit. Diferencat e rrjedhura jane njohur si shpenzim apo e ardhur e periudhes. Per zerat jomonetare nuk eshte bere konvertimi por jane vleresuar me koston e tyre historike, (kursi i kembimit i dates se transaksionit).

Gabime materiale te periudhave te mepareshme

Ne pasqyrat financiare prezente nuk ka efekte te korigjimit te gabimeve materiale te periudhave te mepareshme.

Ngjarjet pas dates se bilancit

Me vendimin e gjykates Administrative te Apelit Tirane eshte vendosur prishja e kontrates se koncensionit. Mbas kesaj nga ana e zyres permbarimore eshte bere egzekutimi i vendimit te gjykates. Ne keto kushte ne muajin shkurt 2020 shoqeria ka nderprere aktivitetin e saj dhe ka filluar ceshtjen gjyqesore. Nga ana e avokateve te shoqerise eshte dhene opinionin se mundesia e fitimit te ceshtjes eshte mbi 50%. Ne

pasqyrat financiare prezent nuk eshte regjistruar ndonje efekt financiar qe vjen nga vleresimi i ketyre ngjarjeve te ndodhura pas dates se mbylljes se bilancit.

Parimi i vijimesise

Ne keto pasqyra financiare eshte vleresuar situata lidhur me ngjarjet pas dates se bilancit te pershkruara ne paragrafin e meparshem. Ne vleresimin e drejtimet te shoqerise ky fakt nuk eshte evidentuar si nje faktor qe mund te paraqese pasiguri lidhur me vazhdimesine e veprimtarise se njesise ekonomike raportuese.

REZULTATI FINANCIAR

Shoqeria gjate ushtrimit 2020 ka rezultuar me nje Humbje bruto prej -834,455,495 leke e cila paraqitet si me poshte :

Te ardhura te ushtrimit	133,514,074 leke
Shpenzime te ushtrimit	- 967,869,571 leke
Fitimi bruto para tatimit	- 834,355,497 leke
Shpenzime te panjohura	824,795,865 leke
Fitimi i tatueshem	9,559,632 leke
Norma e Tatim fitimit	15%

- Te ardhura e paraqitura ne postin "shitje neto" te pasqyres te te ardhurave e shpenzimeve, te cilet perputhen me deklarimin e shitjeve ne FDP, viti 2020, jane :

1. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	109,374,477 leke
2. Te ardhura nga aktivitete te tjera ,shitje AQT	14,216,159 leke

TOTALI

123,590,636 leke

- Te ardhura nga veprimtaria financiare
 - Shpenzimet financiare
- | | |
|--|---------------|
| | 9,923,439 lek |
| | 39,391 lek |

Gabime materiale te periudhave te mepareshme

Ne pasqyrat financiare prezente nuk ka efekte te korigjimit te gabimeve materiale te periudhave te mepareshme.

Numuri i te punesuarve:

Kategoria	Gjendja ne fillim	Pranime	Largime	Gjendja ne fund
Punetore	84	0	84	0
Nepunes	5	0	4	1
Drejtues	3	0	1	2
Totali	92	0	89	3

Durres, 12.03.2021

